

UDHËZIM
Nr.2, datë 11.3.2010

MBI KONTROLLIN TEKNIK TË MJETEVE RRUGORE
(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 2, datë 17.4.2014; nr. 7, datë 7.10.2014)
(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në zbatim të direktivës 2009/40 EC, datë 6.5.2009 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Neni 1

1. Të gjitha mjetet rrugore, që regjistrohen dhe qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, i nënshtrohen kontrollit teknik të detyrueshëm.
2. Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore përfshin:
 - kontrollin teknik vjetor (KTV);
 - kontrollin teknik periodik (KTP).
3. Afati kohor i kryerjes së KTV-së së detyrueshme është 1 (një) vit dhe kryhet për të gjitha mjetet rrugore të përcaktuara në pikën 1, germa “f” deri në “l”, të nenin 47 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.
4. Afati kohor i kryerjes së KTV-së së detyrueshme, për mjetet e reja rrugore, është pas 1 (një) viti nga data e regjistrimit të tij të parë.
5. Afati kohor i kryerjes së KTP-së së detyrueshme është 6 (gjashtë) muaj pas kryerjes së KTV-së së detyrueshme dhe kryhet për të gjitha mjetet rrugore, si më poshtë:
 - taksistë;
 - mjetet rrugore, që përdoren për qëllime mësimore në autoshkola;
 - autoambulancat;
 - autoveturat me 8+1 vende, duke përfshirë dhe vendin e drejtuesit të mjetit;
 - autobusët;
 - mjetet rrugore që përdoren për transportin e mallrave të rrezikshme.
6. Drejtuesit e mjeteve rrugore duhet të dorëzojnë te subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik vjetor KTV kontratën e sigurimit të mjetit. Në të kundërt ky shërbim nuk kryhet.
7. Drejtuesit e mjeteve rrugore që kanë tahograft të instaluar në mjet, duhet të paraqesin te subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik vjetor (KTV) certifikatën e kryerjes së operacionit teknik (inspektim/kalibrim) të tahograft, të lëshuar nga ofiçina e autorizuar. Në të kundërt ky shërbim nuk kryhet.

Neni 2

1. Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore kryhet në qendrat e kontrollit teknik (QKT) të miratuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Shërbimi i KTV-së dhe i KTP-së, të detyrueshme, kryhet nga subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit në të gjitha QKT-të e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

1. Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore, pra KTV dhe KTP, do të kryhet sipas “Manualit të kontrollit të mjeteve”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. “Manuali i kontrollit të mjeteve” është përpiluar plotësisht sipas direktivës 2009/40 EC, datë 6.5.2009 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. “Manuali i kontrollit të mjeteve” përfshin të gjitha kushtet teknike të kontrollit të mjeteve rrugore, elementet mbi të cilat kryhet ky kontroll, si dhe mënyrën e diagnostikimit për funksionimin normal të tyre.

4. “Manuali i kontrollit të mjeteve” ka 3 (tre) kapituj.

Kapitulli i parë. Kontrolli teknik i detyrueshëm i autoveturave dhe i mjeteve rrugore me peshë maksimale me ngarkesë deri në 3,5 tonë.

Në kapitullin e parë përcaktohen elementet për të cilat duhet të kryhet kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, që përfshihen në kategoritë ndërkombëtare, si më poshtë:

- Kategorija M1, mjete me motor që kanë të paktën 4 (katër) rrota, të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se 8 (tetë) ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit.

- Kategorija N1, mjete me motor që kanë të paktën 4 (katër) rrota, të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë.

- Kategorija O1, rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë.

- Kategorija O2, rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë dhe jo më të madhe se 3,5 tonë.

Kapitulli i dytë. Kontrolli teknik i detyrueshëm i autobusëve dhe mjeteve rrugore me peshë maksimale me ngarkesë mbi 3,5 tonë.

Në kapitullin e dytë përcaktohen elementet për të cilat duhet të kryhet kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, që përfshihen në kategoritë ndërkombëtare, si më poshtë:

- Kategorija M2, mjete me motor që kanë të paktën 4 (katër) rrota, të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 5 tonë.

- Kategorija M3, mjete me motor që kanë të paktën 4 (katër) rrota, të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë.

- Kategorija N2, mjete me motor që kanë të paktën 4 (katër) rrota, të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë dhe jo më të madhe se 12 tonë.

- Kategoria N3, mjete me motor që kanë të paktën 4 (katër) rrota, të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë.

- Kategoria O3, rimorkio (përfshirë edhe gjysmërimorkiot) me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë dhe jo më të madhe se 10 tonë.

- Kategoria O4, rimorkio (përfshirë edhe gjysmërimorkiot) me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.

Kapitulli i tretë. Kontrolli teknik i detyrueshëm i motomjeteve

Në kapitullin e tretë përcaktohen elementet për të cilat duhet të kryhet kontrolli teknik i motomjeteve, që përfshihen në kategoritë ndërkombëtare, si më poshtë:

- Kategoria L3, mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cc dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 50 km/orë.

- Kategoria L4, mjete me tri rrota asimetrike ndaj aksit gjatësor të mesit, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cc dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe 50 km/orë (motorë me kosh).

- Kategoria L5, mjete me tri rrota simetrike ndaj aksit gjatësor të mesit, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cc dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 50 km/orë.

5. Kontrolli dhe vlerësimi i gjendjes teknike të mjeteve rrugore, pra KTV dhe KTP të detyrueshme, bëhen sipas metodikave të përshkruara në “Manualin e kontrollit të mjeteve”. Gjatë kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore, gjendja teknike e tyre mund të rezultojë:

a) Pa mangësi dhe pa defekte. Në këtë rast, kontrollorët:

- lëshojnë raportin e kontrollit teknik;

- lëshojnë certifikatën e kontrollit teknik të plotësuar, me vlefshmëri 1-vjeçare (njëvjeçare);

- plotësojnë dhe vulosin lejen e qarkullimit (kontrolli teknik);

- vendosin në mjetin rrugor pullën e kontrollit teknik.

b) Me mangësi apo defekte dytësore, që nuk paraqesin rrezik për sigurinë rrugore, ndotjen e mjedisit dhe nuk shmangin respektimin e kushteve teknike të kontrollit të mjetit rrugor, të cilat në “Manualin e kontrollit të mjeteve”, paragrafi “Arsyet për dështim”, janë të përcaktuara me “x” në kolonën “K” (Kalon). Në këtë rast, kontrollorët:

- lëshojnë raportin e kontrollit teknik;

- bëjnë prezent tek drejtuesi i mjetit rrugor mangësitë apo defektet e konstatuara;

- lëshojnë certifikatën e kontrollit teknik të plotësuar, me vlefshmëri 1-vjeçare (njëvjeçare);

- plotësojnë dhe vulosin lejen e qarkullimit (kontrolli teknik);

- vendosin në mjetin rrugor pullën e kontrollit teknik.

c) Me mangësi apo defekte të rënda, në elementet konstruktive dhe funksionale që për nga karakteri përbëjnë rrezik serioz dhe të palejueshëm për sigurinë e qarkullimit dhe identitetin e mjetit, të cilat në “Manualin e kontrollit të mjeteve”, paragrafi “Arsyet për dështim”, janë të përcaktuara me “x” në kolonën “S” (s’kalon). Në këtë rast, kontrollorët:

- lëshojnë raportin e kontrollit teknik, me vlefshmëri 1 (një) muaj, jo për të qarkulluar mjeti rrugor, por për të pasur kohë për riparimin e defekteve;

- bëjnë prezent tek drejtuesi i mjetit rrugor rezultatin “negativ” të kontrollit teknik

dhe mangësitë apo defektet e konstatuara, të cilat duhen eliminuar për të hyrë në rikontrollin e mjetit.

Nëse nga rikontrolli konstatohet se mangësitë apo defektet janë eliminuar, pra kemi rezultat “pozitiv” të kontrollit teknik, atëherë kontrollorët:

- lëshojnë raportin e kontrollit teknik;
- lëshojnë certifikatën e kontrollit teknik të plotësuar, me vlefshmëri 1-vjeçare (njëvjeçare);
- plotësojnë dhe vulosin lejen e qarkullimit (kontrolli teknik);
- vendosin në mjetin rrugor pullën e kontrollit teknik.

6. Procedurat e përshkruara në pikën 5 të këtij neni, zbatohen si për KTV-në, ashtu dhe për KTP-në, të detyrueshme të mjeteve rrugore.

Neni 4

1. Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore kryhet sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Tarifat e rikontrollit teknik të mjeteve rrugore janë si më poshtë:

a) Në rast të rikontrollit teknik të parë brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e kontrollit teknik të parë, është 40 % e tarifës së kontrollit teknik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në rast të përdorimit të linjave të kontrollit dhe është 20% e tarifës së kontrollit teknik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në rast të mospërdorimit të linjave të kontrollit.

b) Për çdo rikontroll teknik të mëpasshëm, pavarësisht numrit të tyre brenda periudhës prej 30 ditësh nga dita e kontrollit të parë, tarifa e rikontrollit teknik është 50 % e tarifës së kontrollit teknik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në rast të përdorimit të linjave të kontrollit dhe është 20 % e tarifës së kontrollit teknik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në rast të mospërdorimit të linjave të kontrollit.

c) Çdo rikontroll teknik i kryer pas periudhës 30-ditore të lartpërmendur do të konsiderohet kontroll nga e para dhe për pasojë do të aplikohet tarifa e plotë e kontrollit teknik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Neni 5

1. QKT-të mbajnë evidencat statistikore të përcaktuara nga organet kompetente ekonomike dhe financiare në nivel lokal dhe qendror.

2. Në zbatim të detyrimeve për kryerjen e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, konform kërkesave të nenit 79 të Kodit Rrugor dhe akteve në zbatim të tij, QKT-të janë të detyruara të mbajnë të dhënat (në elektronikë për mjetet rrugore) si më poshtë:

- certifikatën e vjetër të kontrollit teknik;
- certifikatën e re të kontrollit teknik;
- raportin e kontrollit teknik;
- regjistrin ditor të kontrolleve teknike vjetore;
- regjistrin ditor të kontrolleve teknike periodike;
- regjistrin ditor të defekteve në kontrollet teknike;

- regjistrin e shkeljeve të afatit të kontrollit teknik.

3. Lëshimi nga QKT-të i certifikatës dhe pullës së kontrollit teknik të mjeteve rrugore, përfaqëson dokumentin kryesor që vërteton zbatimin e këtij udhëzimi dhe qëllimet bazë që burojnë prej tij, për kryerjen e KTV-së apo KTP-së, të detyrueshme, konform kërkesave të Kodit Rrugor, akteve në zbatim të tij dhe direktivës 2009/40 EC, datë 6.5.2009 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

4. Modeli i certifikatës dhe i pullës së KTV-së apo KTP-së, të detyrueshme, miratohen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe janë pjesë e këtij udhëzimi, bashkëlidhur. Përdorimi i certifikatave dhe i pullave të kontrollit teknik të pamiratuara, konsiderohen të pavlefshme dhe përbëjnë shkelje që dënohen sipas ligjeve në fuqi. *Në certifikatën e kontrollit teknik do të shënohet numri i serisë së kontratës së sigurimit të mjetit dhe emri i kompanisë që e ka lëshuar.*

5. Subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore, ka për detyrë që udhëzimin për kontrollin teknik, manualin teknik të mjeteve, etj. që kanë lidhje me to, t’ua bëjnë prezent dhe të njohura gjithë personelit të qendrave të kontrollit teknik, nëpërmjet formave të kualifikimit dhe të testimit, me qëllim zbatimin e tyre në veprimtarinë e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore.

Neni 6

Udhëzimi nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore” i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit shfuqizohet.

Neni 7

1. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi